



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 56, datë 29. 09. 2022

**“PËR DISA SHTESA NË VKB-NË NR. 29, DATË 27. 04. 2022, “PËR MIRATIMIN E MUNDËSIVE VJETORE TË SHFRYTËZIMIT PËR SIGURIMIN E DRUVE TË ZJARRIT PËR NGROHJE PËR BANORËT E FSHATRAVE TË BASHKISË SKRAPAR PËR VITIN 2022”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29. 09. 2022, pasi mori në shqyrtim projektaktin e paraqitur nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, hartuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 57/2020, “Për pyjet”, në VKM- në Nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/ Bashkive”, VKM- në Nr.438, datë 08.06.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, në Udhezimin Nr. 2 datë 03.03.2017 “Per kerkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje ”, si dhe në VKB-në Nr. 29, datë 27. 04. 2022, “Për Miratimin e mundësisë së shfrytëzimit për sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje për banorët e fshatrave të Bashkisë Skrapar për vitin 2022- 2023”

**V ENDOSI :**

1. Në VKB-në Nr. 29, datë 27. 04. 2022, “Për Miratimin e mundësisë së shfrytëzimit për sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje për banorët e fshatrave të Bashkisë Skrapar për vitin 2022- 2023”, listës bashkëlidhur këtij vendimi ti shtohet:
  - \*Ngastra 95a, në ekonominë pyjore Dobrenj- Gjokovicë, në sasinë 1206 m<sup>3</sup> dru zjarri dhe lëndë punimi.
  - \* Ngastra 78a, 79a, në ekonominë pyjore Turbohovë - Potom, në sasinë 320 m<sup>3</sup> dru zjarri.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vendimi u miratua me 11 vota pro , vota kundër – s’ka, vota abstenim – s’ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK**  
**Edlira SHKËMBI**

